

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS RINAS, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës Rinas, Tiranë, me objekt “Për zbatimin e legjislacionit doganor”, për periudhën 01.01.2012 - 30.09.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 19, datë 21.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 802/13, datë 21.03.2014 dhe nr. 802/14, datë 21.03.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Armand Uruçi, Kryetar i Degës së Doganës, Rinas.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të rishikojë marrëveshjen nr. 5992/2 prot, datë 18.06.2007, të nënshkruar me subjektin “Posta Shqiptare”, pasi bie ndesh me kërkesat e nenit 46 dhe 65 të Kodit Doganor dhe nenit 504.2 të VKM nr. 205, datë 13.04. 1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”.

2. Nga Dega e Doganës Rinas në bashkëpunim me Departamentin Operativ Hetimor pranë DPD të meren masa për investigimin e faturave në praktikat doganore DAV, R-6168; R-12543 datë 26.10.2012, DAV R-21485, R-20235 të vitit 2012 dhe DAV R-4043 datë 28.02.2013 referuar parashikimit të DD Rinas mbi kundrvatjet administrative në këto praktika dhe DAV R-21485, R-20235 të vitit 2012 dhe R-9413; R-15779, të vitit 2013 me MSABE të shoqëruara me fatura fotokopje, praktika që nuk përputhen me kriteret mbi rregullat e origjinës preferenciale sipas MTL dhe kërkesat e Kodit Doganor.

3. Nga Dega e Doganës Rinas në bashkëpunim me Departamentin Teknik pranë DPD të meren masa për klasifikimin e saktë të Kodit Tarifror të artikujve të Deklaruar në praktikat doganore DAV R-10578, datë 09.06.2012, DAV R-16173, datë 20.08.2013 dhe DAV R-24890, datë 28.12.2012, pasi sipas të dhënave nga interneti rezultojnë “aparate për ruajtjen dhe sigurinë e ndërtesave” dhe jo “çelsa automat”, trajtuar në RPA faqe 12-31.

4. Nga Kryetari i Degës së Doganës Rinas të analizohen shkaqet dhe të dalin përgjegjësitë përkatëse për: mospërputhjet e konstatuara në procedurat e arkivimit dhe protokollit; në procedurat për veprimet me mallrat sekuestro dhe ato të konfiskuara, të pa dorëzuara në magazinat e Rezervave Materiale të Shtetit; të metat e mangësitë në procedurat e vendimmarrjes së autoritetit doganor kompetent si mos regjistrimin në librat e autoritetit doganor të procesverbaleve dhe praktikave shkresore në hyrje sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe të nenit 285 të KD; për praktikat doganore të përpunuara nga Terminali i Posagjerëve, në shkelje të neneve 34-37 të KD dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007

të MF, “Për shqyrtimin e vlerës doganore”, të cilësuar në emërtim, por të pa specifikuar në copë për secilin artikull, si dhe të merren masa për sigurimin e përputhshmërisë së procedurave në të ardhmen.

5. Nga Dega e Doganës Rinas të merren masa për rimbursimin në rrugë ligjore të detyrimit doganor në vlerë 50,179 lekë, e cila rezulton e kontabilizuar dhe e arkëtuar më tepër si pasojë përlllogaritjes së gabuar të kursit këmbimit monetar.

6. Nga Dega e Doganës Rinas të ndiqet me përparësi rikuperimi dhe vjelja e borxhit doganor nga subjektet ■■■ në vlerë 427,213 lekë, ■■■, në vlerë 296,822 lekë, ■■■ në vlerë 52,355 lekë dhe subjekti ■■■ në vlerë 30,943 lekë, në total **807,333 lekë** si dhe të fillojë procedura për rimbursimin e shumës prej 50,179 lekë subjekteve ■■■ arkëtuar më tepër si rezultat i gabimeve në llogaritjen e kursit të këmbimit monetar, në përputhje me kërkesat e nenit 245 të KD, si dhe të udhëzimit nr. 4 datë 04.08.2006 të DPD “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor”.

7. Dega e Doganës Rinas në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të kryej inventarin fizike e kontabël të pësursisë për vitin 2013, për të mundësuar përfshirjen e rezultateve të tij në bilancin e vitit ushtrimor dhe të marrë masa për nxjerrjen jashtë përdorimi të artikujve të miratuar nga DPD **në vlerën prej 2,379,329 lekë.**

8. Dega e Doganës Rinas, në bashkëpunim me Drejtorinë e Fincës pranë DPD-së, të sigurojë rakordimin e tepërisë së llogarisë kreditor e debitor të sistemit, me Degët e tjera Doganore, duke mundësuar kështu sistemimet e nevojshme. Po kështu me veprimet e mbylljes së bilancit të bëhet sistemimi i veprimit të kryer për llogarinë nr. 409 dhe 475.

9. Dega e Doganës Rinas, në bashkëpunim me DPD të studiojë mundësinë e investimit konkret në lidhje me ndërtimin e zyrave për administratën doganore, për faktin se qeraja mujore që paguhet nga ky subjekt prej 1.875 euro/muaj, nuk është ekonomike dhe eficiente, kjo edhe për faktin e thjeshtë se ambientet e marra me qera nuk janë funksionale dhe përshtatshme për zyra.

10. Nga Dega e Doganës Rinas, të merren masa që në zbatim të vendimit nr. 230, datë 04.02.2014 të autoritetit doganor kompeten Rinas, për rregullimin e situatës mbas konstatimit të KLSH lidhur me konfiskimin e artikujve të sekuestruar nga kontrabanda dhe kontabilizuar **në vlerë 1,762,815 lekë**, të dërgohen në magazinën e rezervave materiale të shtetit, në zbatim të dispozitave ligjore.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Dega e Doganës Rinas, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e

gjyqësorit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **vlërë 2,531,123 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **2,197,079 lekë**, nga subjekte të cilëve ju përkasin 29 raste, sipas aneksit 1 dhe 1/1, të RPA, për detyrimet doganore të papaguara së bashku me sanksionet.
2. Vlera prej **200,124 lekë**, nga subjektet që u përkasin dy rasteve të mos revokimit të vendimeve të mëparshme nr. 354, datë 25.01.2013 dhe nr. 1520, datë 16.04.2013.
3. Vlera prej **133,920 lekë** nga subjektet me detyrime doganore të rezultuara nga auditimi i vendimeve administrative.

C. MASA ADMINISTRATIVE

1. Nga Dega e Doganës Rinas të ndërmerren hapat ligjorë, për aplikimin e sanksioneve sipas përcaktimeve në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, ndaj subjekteve që kanë rezultuar me shkelje në fushën doganore si dhe penalitet me gjobë nga 50,000 – 200,000 lekë për 6 (gjashtë) agjencitë doganore: [] në 26 raste, [] në 14 raste, [] në 8 raste, si dhe [], [] dhe [] me nga tre raste shkeljesh në procedurat e zhdoganimit të mallrave dhe vendimeve të autoritetit doganor kompetent, aneksi 4 i RP të Auditimit.

D. MASA DISIPLINORE

1. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 205, datë 13.4.1999 të ndryshuar me vendimin nr. 686, datë 02.11.2005, për shkeljen e dispozitës nr. 16.1 germat “a” dhe “ë”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të propozojë në Komitetin Disiplinor fillimin e procedurës për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

“Verejtje me Paralajmërim”, dispozita 18.1.4 qërma “a,”:

-Për 3 (tre) punonjës me detyrë Përgjegjës Turni në Sektorin Operacional (Terminali i Posagjerëve), për shkeljet doganore të kryera gjatë realizimit të detyrave funksionale të përcaktuara nga nenet 15.13 dhe 15.16 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, për zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve 261.1, 261.2 dhe 33-37 të Kodit Doganor. Trajtuar në faqet 12-31 të RPA.

“Gjobë 0,5 pagë mujore”, dispozita 18.1.4 qërma “b”:

-Për 2 (dy) punonjës me detyrë doganierë verifikim /vlere, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, në zhdoganimin e mallrave në shkelje të neneve përkatësisht: neni 261.1, 261.2 dhe 33-37 të Kodit Doganor. Trajtuar rast pas rasti në faqet 12-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për të meta dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 3 ish-punonjës me detyrë përkatësisht, dy ish-Kryetarë të Degës Doganore dhe një ish- financiere, për arsye se ata i kanë shkëputur marrëdhëniet me sistemin doganor.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Livan Hoxha, p/grupi, Agron Opari, Bashkim Shehu, dhe Anesti Gjika, më tej u shqyrtua nga K/audituesi z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës Rinas, Tiranë me shkresën nr. 1263, datë 14.04.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se janë marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Nga 10 masa organizative, është realizuar 1 (një) dhe janë në proces 9 (nëntë) për të cilat po punohet që të realizohen, nga 3 masa shpërblim dëmi në vlerë 2,531,123 lekë, janë vlerësuar dy ndërsa një masë nuk është marë në konsiderate, masat administrative janë në proces verifikimi dhe analizimi për të nxjerrë vendimet përkatëse si dhe nuk janë zbatuar masat disiplinore.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT